



**RREGULLORE NR. 2004/47**

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E  
BANORËVE TË KOSOVËS NË SISTEMIN E KUJDESIT SHOQËROR TË  
MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenin 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marrë parasysh komunikatën nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 28 shtator 2004 përkitazi me Ligjin nr. 2004/38 mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve të Kosovës për kujdesin shëndetësor të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 8 shtator 2004,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shëndetësor, ashtu siç është miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 2004/38) i bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe i cili bëhet i plotfuqishëm në ditën e nëshkrimit, me ndryshimet vijuese:

(a) Titulli i ligjit ndryshohet si vijon: “Të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shëndetësor”;

(b) Neni 2.1 (a) ndryshohet si vijon:

**Banor i Kosovës:** banor i përhershëm i Kosovës ose personi i cili i plotëson kushtet për t’u regjistruar si banor i përhershëm i Kosovës;

(c) Kudo që përdoret termi “qytetar” për banor të Kosovës duhet të zëvendësohet në mënyrë përkatëse në pajtim me (b) lart.

Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të ligjit.

Nënshkruar më 19 nëntor 2004.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm